



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 628/4 Prot

Tiranë, më 19/6/2020

VENDIM

Nr. 15, datë 19.6.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 628 Prot., datë 04.06.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, nëpërmjet shkresave të datës 18.05.2020, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion të dokumentacionit të plotë për disa procedura prokurimi si më poshtë:

1. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt: “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP, Loti 2- Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP”;
2. Një kopje të kontratës së lidhur me Biometric Albania SHPK, për kontratën me objekt: “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese



- për COVID-19 në ISHP. Loti 2-Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP”;
3. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt: “Blerje barna kundër Coronavirus COVID-19, Loti 5 - Blerje barna Oseltamivir (Tamiflu) 75 mg/tabletë”;
  4. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë Rejsi FARMA Sh.p.k për kontratën me objekt: “Blerje barna kundër Coronavirus COVID-19 - Loti 5 - Blerje barna Oseltamivir (Tamiflu) 75 mg/tabletë”;
  5. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt “Blerje barna kundër Coronavirus COVID-19: Loti 8 - Blerja barna Omeprazol 40 mg/vial flakon”;
  6. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë Rejsi FARMA Sh.p.k për kontratën me objekt: “Blerje barna kundër Coronavirus COVID-19: Loti 9 - Blerje barna Propofol 10 mg/ml– 50 ml Flakon”;
  7. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt: “Blerje barna kundër Coronavirus COVID-19: Loti 10 -Blerje barna Beclomethasone + Salbutamol 80 mcg+1600 mcg flakon”;
  8. Një kopje të kontratës së lidhur me MEGAPHARMA Sh.p.k për kontratën me objekt: “Blerje barna kundër Coronavirus COVID–19: Loti 8 - Blerja barna Omeprazol 40 mg/vial flakon”;
  9. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt: “Blerje barna kundër Coronavirus COVID-19: Loti 9 - Blerje barna Propofol 10 mg/ml – 50 ml Flakon”;
  10. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë MEDICAMENTA Sh.p.k për kontratën me objekt: “Blerje barna kundër Coronavirus COVID-19: Loti 10 Blerje barna Beclomethasone + Salbutamol 80 mcg+1600 mcg flakon”;
  11. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt: “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP”;
  12. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë KRIJON shpk, për kontratën me objekt: “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP”;
  13. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt: “Produkte letre si dhe spostimin e sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve të QSUT-së të godina e spitalit infektiv në QSUT (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19), Loti 1-Furnizime produkte letre



- njëpërdorimshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjienike, për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor”;*
14. *Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë EURO MEGA Sh.p.k për kontratën me objekt: “Produkte letre si dhe spostimin e sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve të QSUT-së te godina e spitalit infektiv në QSUT (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19). Loti I -Furnizim me produkte letre njëpërdorimshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjienike, për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor”;*
  15. *Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen Maglum 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP. Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen Maglum 800 të Snibe Co.ltd ose Ekuivalent pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor;*
  16. *Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë GENIUS Sh.p.k, për kontratën me objekt: “Produkte letre si dhe spostimin e sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve të QSUT-së te godina e spitalit infektiv në QSUT (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19). Loti I -Furnizim me produkte letre njëpërdorimshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjienike, për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor;*
  17. *Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 18.04.2020, me objekt: “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen Maglum 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP. Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen Maglum 800 të Snibe Co.ltd ose Ekuivalent pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor”;*
  18. *Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë TEOREN Sh.p.k, për kontratën me objek: “Produkte letre si dhe spostimin e sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve të QSUT-së te godina e spitalit infektiv në QSUT (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19). Loti I -Furnizim me produkte letre njëpërdorimshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjienike, për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor”;*
  19. *Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Drejtësisë për tenderin e organizuar më 06.04.2020, me objekt “Blerje materiale mjekësore në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19”;*
  20. *Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë FEDOS Sh.p.k, për kontratën me objekt: “Blerje materiale mjekësore në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19”;*
  21. *Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 03.04.2020, me objekt: “Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19”;*



22. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë T B S 96 Sh.p.k për kontratën me objekt: "Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19";
23. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 03.04.2020, me objekt: "Blerje kite dhe reagentë, evadim mbetje anti COVID-19 ndarë në dy lote: Loti 1 me objekt "Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për t'u përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalent";
24. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë OES Distrimed Sh.p.k, për kontratën me objekt: "Blerje kite dhe reagentë, evadim mbetje anti COVID-19 ndarë në dy lote: Loti 1 me objekt "Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për t'u përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalent";
25. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 03.04.2020, me objekt: "Blerje kite dhe reagentë, evadim mbetje anti COVID-19 ndarë në dy lote: Loti 2 "Trajtim dhe asgjësim të mbetjeve që dalin nga shërbimet ku marrin trajtim pacientët me COVID-19 për QSUT";
26. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë ECO RIKIKLIM për kontratën me objekt: "Blerje kite dhe reagentë, evadim mbetje anti COVID-19 ndarë në dy lote: "Blerje kite dhe reagentë, evadim mbetje anti COVID-19 ndarë në dy lote: - Loti2 "Trajtim dhe asgjësim të mbetjeve që dalin nga shërbimet ku marrin trajtim pacientët me COVID-19 për QSUT";
27. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 21.03.2020, me objekt: "Blerje materiale për mbrojtjen personale (mmp) për COVID-19";
28. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë Farma Net Albania Sh.p.k EUROMED Sh.p.k, për kontratën me objekt: "Blerje materiale për mbrojtjen personale (mmp) për COVID-19";
29. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për tenderin e organizuar më 14.05.2020, me objekt: "Blerje materiale për mbrojtjen personale për COVID-19";
30. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë EGIAN MED sh.p.k, Distributor of Medical Devices Group Sh.p.k me drejtues "Luftar Zebi": "Blerje materiale për mbrojtjen për COVID-19";
31. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Postës Shqiptare Sh.a, për tenderin e organizuar më 14.05.2020, me objekt "Blerje materiale për mbrojtjen personale për COVID-19";
32. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë "Farma Net Albania" Sh.p.k, "Blerje materiale për mbrojtjen për Covid-19";
33. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, për tenderin e organizuar më 14.04.2020, me objekt: "Blerje materialet e linjave të oksigjenit të nevojshme në Shërbimin Infektiv dhe atë të Pediatriisë";



34. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë Shogërinë "GTS-Gazra Teknike Shqiptare" Sh.p.k, për tenderin e organizuar më 14.04.2020, me objekt: "Blerje materialet e linjave të oksigjenit të nevojshme në Shërbimin Infektiv dhe atë të Pediatriisë";
35. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tenderin e organizuar më 03.04.2020, me objekt: "Prokurim me mjete elektronike - mallra, REF-49328-02-05-2020";
36. Një kopje të kontratës së lidhur me kompanitë, GTS-Gazra Teknike Shqiptare shpk dhe Messer Albagaz shpk për objektin: "Prokurim me mjete elektronike - mallra, REF-49328-02-05-2020";
37. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër për tenderin e organizuar më 14.05.2020, me objekt: "Riparim Sistemi oksigjenimit";
38. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë "GTS Gazra Teknike Shqiptare" sh.p.k me objekt: "Riparim Sistemi oksigjenimi";
39. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Autoriteti Portual Durrës për tenderin e organizuar më 07.05.2020, me objekt: "Masa mbrojtëse ndaj Covid 19 për personelin e APD-së";
40. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë "ORTHONET 360" sh.p.k, me objekt: "Masa mbrojtëse ndaj Covid 19 për personelin e APD-së";
41. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Agjencia e Parqeve dhe e Rekreacionit për tenderin e organizuar më 06.04.2020, me objekt: "Shpenzime qeramarrje për mjete transporti (Mjete transporti specifike me qera) Mjetet përdoren për përballimin e nevojave të COVID-19";
42. Një kopje të kontratës së lidhur me objekt: "Shpenzime qeramarrje për mjete transporti (Mjete transporti specifike me qera) Mjetet përdoren për përballimin e nevojave të COVID-19";
43. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për tenderin e organizuar më 05.05.2020, me objekt: "Blerje Maska Kirurgjikale njëpërdorimshme të thjeshta në kuadër të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19";
44. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë "OrthoNet" me objekt: "Blerje Maska Kirurgjikale njëpërdorimshme të thjeshta në kuadër të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes se virusit Covid-19";
45. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për tenderin e organizuar më 16.04.2020, me objekt: "Blerje aksesore mbrojtës ndaj Covid-19";
46. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë "LEL-Medical" sh.p.k me objekt: "Blerje aksesore mbrojtës ndaj Covid-19";
47. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Bashkia Krujë për tenderin e organizuar më 20.04.2020, me objekt: "Blerje pajisje e veshje për dizinfektim anti COVID 19";
48. Një kopje të kontratës së lidhur me Albert Doku NIPT-i K33710231Q me objekt: "Blerje pajisje e veshje për dezinfektim anti COVID 19";
49. Një kopje të procedurave të ndjekura nga Bashkia Krujë për tenderin e organizuar më 22.04.2020, me objekt "Blerje pajisje e veshje për dezinfektim anti COVID-19";



50. Një kopje të kontratës së lidhur me kompaninë EURO MEGA me objekt: "Blerje pajisje e veshje për dezinfektim anti COVID 19";
51. Një kopje të procedurave të ndjekura nga "Posta Shqiptare" Sh.a. për tenderin e organizuar më 25.03.2020, me objekt: "Për blerje e pajisjeve mbrojtëse ndaj COVID-19";
52. Një kopje të kontratës së lidhur me "Farma Net Albania" me objekt: "Për blerje e pajisjeve mbrojtëse ndaj COVID-19";

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 3080/1 Prot., datë 26.05.2020, ka kthyer përgjigje duke referuar faqen elektronike dhe linkun përkatës, në të cilën gjendet i publikuar një pjesë e informacionit të kërkuar. Gjithashtu ka sqaruar se, procedurat e prokurimit të cilat janë të arkivuara në sistem, kaluar në Arkivën Elektronike, mund të aksesohen vetëm nga autoriteti kontraktor.

Në vijim, Autoriteti Publik, ka argumentuar se: "...bazuar në germën g.) të pikës 2, të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ky autoritet monitoron mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit elektronik në përgjithësi, por nuk ka akses në procedurat e prokurimit që zhvillojnë autoritetet kontraktore. Bazuar në pikën 1, të nenit 12 të ligjit të sipërcituar, autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Referuar këtij parashikimi ligjor, autoriteti kontraktor është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit, ndaj edhe dokumentacioni i procedurave të prokurimit, si dhe kontratave të nënshkruara në përfundim të këtij procesi administrohet prej tij".

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Zyra e Komisionerit, nëpërmjet shkresës nr. 628/2 Prot., të datës 09.06.2020, ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Në vijim, me anë të shkresës nr. 3562/1 Prot., datë 12.06.2020 Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje për Zyrën e Komisionerit, duke vënë në dijeni dhe ankuesen. Në shkresën e tij Autoriteti Publik ka vënë në dispozicion linkun përkatës në të cilin mund të gjendet një pjesë e informacionit të kërkuar, konkretisht lidhur me njoftimet e fituesit dhe dokumentat



e tenderit për procedurat e prokurimit të publikuara nga autoritetet kontraktore, të cilat janë në proces.

Gjithashtu, Autoriteti Publik ka sqaruar se një pjesë tjetër e informacionit të kërkuar gjendet në Buletinin e Njoftimeve Publike, në tabin “Njoftim fituesi” dhe “Njoftim i lidhjes së kontratës”, në portalin e Autoritetit Publik.

Përsa i përket procedurave të prokurimit të cilat mund të jenë të arkivuara në sistem dhe kanë kaluar në Arkivën Elektronike, Autoriteti Publik informon se ato mund të aksesohen vetëm nga autoriteti publik.

Ndërkohë, përsa i përket dokumentacionit të plotë të procedurave të prokurimit të kërkuara nga ankuesja, Autoriteti Publik shprehet se: *“Dokumentacioni i plotë i procedurave të prokurimit të zhvilluara nga një autoritet kontraktor, administrohet nga ky i fundit”*.

Pas analizimit të dokumentacionit dhe informacionit të administruar, si dhe legjislacionit në fuqi Zyra e Komisionerit vlerëson se, informacioni i kërkuar nga znj. \_\_\_\_\_, në parim, përbën informacion publik, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Referuar legjislacionit specifik në fushën e prokurimeve publike, konkretisht ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenet 12 dhe 13 të tij, parashikojnë përgjegjësitë e autoritetit kontraktor dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik në cilësinë e Autoriteti Publik në kuptim të ligjit për të drejtën e informimit.

Neni 12 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikon se:

*1. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.*

*2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:*

*a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;*

*b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;*

*c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;*

*ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;*

*d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;*



- dh) vlerën ose mënyrën e përlllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
- e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
- ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
- f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;
- g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

3. Autoriteti kontraktor administron për të gjitha procesverbalet për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit.

3/1. Në rastin e prokurimit elektronik, raporti i realizuar nga vetë sistemi, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit me mjete elektronike, bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

Ndërkohë, neni 13, pika "g" e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, parashikon se Agjencia e Prokurimit Publik/Autoriteti Publik: g) verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, shqyrton rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit, si dhe monitoron mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore.

Bazuar në sa më sipër, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nuk parashikon detyrimin e Autoritetit Publik/Agjencia e Prokurimit Publik për të administruar kopje të plotë të dokumentacionit të procedurave të prokurimit të kryera nga autoritetet kontraktore.

Detyrimi për mbajtje të procesverbaleve dhe dokumentacionit të plotë për procedurat e kryera, në bazë të nenit 12 të ligjit të sipërcituar, është i autoritetit kontraktor.

Pavarësisht sa më sipër, në pikat 2 dhe 3 të nenit 12 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", parashikohet se:

2. "Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin.

3. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa."

Sa më sipër parashikohet gjithashtu dhe në germën "d", të pikës 2, neni 10 i ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" sipas të cilit "koordinatori për të drejtën e informimit dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të



*parashikuar në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.*

Bazuar në këtë këto parashikime, Zyra e Komisionerit vlerëson se koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik nuk ka vepruar në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar, për delegimin e kërkesës për informim tek *autoriteti kompetent* përkatës. Referuar vetë funksionit dhe përgjegjësi të Autoritetit Publik, koordinatori për të drejtën e informimit gëzon kapacitetin dhe informacionin e nevojshëm për të identifikuar autoritetin publik përkatës, që disponon dokumentacionin e kërkuar.

Si rrjedhojë, koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, duhet të kishte trajtuar më tej kërkesën e paraqitur, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duke e deleguar tek autoriteti publik përkatës.

Zyra e Komisionerit thekson se e drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 628 Prot., datë 04.06.2020 të znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Agjencisë së Prokurimit Publik”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik për delegimin e kërkesave për informim pranë autoriteteve që disponojnë informacionin e kërkuar brenda datës 26. 6.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 13. 6.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

